

*Handwritten:*  
M. 5306

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### DIEL SHPK

#### KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE,  
KOHEZGJATJA

#### NENI 1

##### EMERTIMI

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenit 64 te ligjit 7667 date 28.1.1993 per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kontrates qe i bashkohet ketij statuti, ortaket :

1 z. Nuri Balla, i biri i Qamilit, dtl. 1966, lindur ne Okshtun, Diber, banues ne Elbasan, lagjja Partizani.

2. z. Latif Sula, i biri i Zylyfit, dtl. 1941, lindur ne Diber, Borove dhe banues ne Elbasan, rruga Abdyl Sula, lagjja Partizani, Pall. 413, hyrja nr.6.

te cilet kane krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DIEL" SH.P.K.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar DIEL SHPK fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj themeluese, si ky statut dhe Kontrata qe i bashkohet dhe qe perben nje pjese te pandare te saj.

*Handwritten signature:*  
S. Balla

*Handwritten signature:*  
L. Sula

- 2 -

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DIEL" SHPK eshte :

- Ne fushen e ndertimit, punime dheu, murature, betoni, betonarme te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restuaurimio, prodhime e tregtime te materialeve te ndertimit, investime te ndryshme turistike si dhe tregtim te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti.

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj. Qendra e cdo ortaku eshte e regjistruar ne librin e shoqerise DIEL SHPK. Ajo mund te hape zyra perfaqesimi, agjenci, filiale, apo qendra dytesore mbeshtetur ne kriteret e miratuara nga organet perkatese, si dhe te legjislacionit te vendit ku ato hapen.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DIEL" eshte ne Elbasan, rruga Abdyl Sula, lagjja Partizani, pall.413, nr.6.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar DIEL sh.p.k. eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet perpara ketij afat me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve, ose kur verifikohen rrethana te tilla, kur shperndarja e saj urdherohet ne menyre te prere nga ligji.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT OSE PJESET

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise "DIEL" sh.p.k. eshte 100.000 LEKE, i ndare ne kuota te barabarta midis ortakeve nga 50 % secilit.

*Sanj Sula*  
*Sanj Sula*

*Sanj Sula*  
*Sanj Sula*

Neni 6

Ndryshimi i mases se kapitalit themeltar si per shtimin apo pakesimin e tij behen me vendim te Asamblese se Ortakeve me unanimitet.

Neni 7

Kuotat ose pjeset jane nonimative dhe lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Transferimi i tyre behet vetem me akt noterial e cdo transferim i tyre tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaket.

Neni 8

Kuotat ose pjeset jane nominative dhe lirisht te transferueshme midis ortakeve. Transferimi i tyre behet vetem me akt noterial e cdo transferim i tyre tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaket. Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandarshme. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

KREU III  
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 10

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar DIEL. Vendimet e saj ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrueshme per te gjitha ortaket, duke perjashtuar te drejten e tyre te ankimit kunder veprimeve qe ata i cmojne te demshme per interesat e tyre.

Neni 11

Organi vendimor i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DIEL" sh.p.k. eshte Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve zgjedh Keshillin Administrativ. Keshilli Administrativ zgjedh administratoret qe do ta perfaqesojne ne marredhenie me te tretet. Asambleja mblidhet ne mbledhjet e saj te zakonshme e te jashtezakonshme. Administratore do te jete z.Nuri Balla.

Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton e vendos per ceshtje te tilla si emerim apo shkarkim i administratorit, eksperte dhe kontabilist te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj.

Ne mbledhjet e saj te jashtezakonshme Asambleja e Ortakeve vendos per ceshtje te tilla si, ndryshimet e statutit, zvogelimin e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se Shoqerise apo likuidimi i saj.

*Sami Balla*  
*Administratori*

*Nuri Balla*  
*Administratori*

Neni 12

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DIEL" sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejta e detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaket bartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te kapitalit te investuar ne rastin e krijimit te shoqerise. Ortaket nuk pergjigjen me pasurine e tyre vetjake per detyrimet e shoqerise, te cilen e kane realizuar me veprimtarine e tyre me persona te tretet.

Shoqeria merr persiper vete te drejta e detyrimet.

Neni 13



Shoqeria drejtohet nga nje ose disa administratore qe duhet te jene persona juridik si dhe mund te jene ortak ne shoqeri ose jo. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshem per arritjen e qellimeve te shoqerise, ata kane te drejta midis te tjerave te blejne e te kembejne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te krijohen si brenda ashtu dhe jashte shtetit, duke siguruar pjesemarrje per qellimet e veprimtarise ekonomike. Emerimi i nje administratori behet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Ne marredheniet me ortaket ose me te tretet, administratoret kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise e ne emer te saj. Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit, ose per fajet e kryera gjate administrimit.

Neni 14

Ne rast nevojje ose kur e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar nga ortaket e shoqerise. Ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres nga eksperti kontabel, ky i fundit mund te shkarkohet, shkarkimi i te cilit vendoset me te njejten menyre si dhe emerimi i tij.

Neni 15

Te gjitha te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise, duke vazhduar kete detyre edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.



**KREU IV  
SHPERBERJA E SHOQERISE**

**Neni 16**

Shperberja e shoqerise mund te vij ne cdo kohe dhe per cfaredo shkakku si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie, ose me vendim te Asamblese . Ne kete rast ata vendosin mbi menytrat e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore, duke i percaktuar detyrat. Keto kujdesen qe ne radhe te pare te shlyhen detyrimet qe shoqeria u ka personave te trete.

**Neni 17**

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje Asambleja e Ortakeve, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxirret vete statuti.

**Neni 18**

Te gjitha kundershimit eventuale midis ortakeve te shoqerise zgjidhen nga nje kolegji arbitrar prej tre vetesh, ku secili nga palet cakton nga nje arbiter dhe i treti zgjidhet nga dy te paret ose nga Kryetari i Gjykates se Rrethit. Arbitrat kerkojne zgjidhje ne mirekuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga pjesetaret ne konflikt si shprehje e vete vullnetit te tyre. Vendimet merren ne vendin dhe ne kohen e parashikuar nga Asambleja e Ortakeve.

**Neni 19**

Vendimet e Kolegjit Arbitrat mund te apeloohen vetem nese nje nga palet kerkon arbitrazhe te metejshem prane Gjykates se Rrethit Tirane, ku eshte depozituar ky statut i shoqerise.


**Neni 20**

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatchen dispozitat e legjislacionit shqiptar te punes. Kjo eshte e njejte edhe per filialet, zyrat e perfaqesise apo agjencise.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DIEL".

**O R T A K E T**

Latif Sula



Nuri Balla

